

Biblioteka Publike Roskovec

Në mjeshterit e Pallatit te Kulturës Roskovec, lexuesit dhe dashamirësit e librit, mund të gjunjë një kënd të dedikuar tërësisht kësaj pjesë të komunitetit. “Biblioteka Publike Roskovec”, edhe pse modeste, mirëpret cdo ditë një numër të konsiderueshëm lexuesish. Fillesat e kësaj Biblioteke datojnë diku rrëth viteve 1962-1964, kurse në vitet 1970-1985 numri i librave arriti në rrëth 10 mijë copë. Gjatë periudhës së tranzicionit shumë prej librave humbën, pjesa tjetër u dëmtua. Në vitet e fundit, ka patur përpjekje për të investuar dhe për ta pasuruar me prurje të reja edhe pse i mbetemi besnik fjalës modeste.

Vitin e kaluar në bashkëpunim edhe me Shkollën e Gjuhëve të Huaja u shpalos aksioni kulturor “Dhuro një libër-hap një dritare”. Vetëm gjatë një koncerti u dhuruan rrëth 175 libra. Ndërsa në koncertin me rastin e 7-Marsit vetëm shtëpia botuese “Neraida” me president Jani Malo dhuroi 180 libra. Ky aksion është i hapur dhe vazhdojnë të vijnë libra të tjere.

Në ambientet e Bibliotekës, mund të gjeni një kënd leximi për të gjithë ata që duan të kalojnë disa orë në shoqërinë e librit dhe larg rutinës së përditshmërisë. Në rastet e bibliotekës do të gjeni një larmi librash me tema të ndryshme si: sociale, edukative, informuese, argëtuese... Gjithashtu letërsi të huaj dhe shqiptare, nga autorë të mirënjohur dhe letrarë të rinj. Një kënd i është dedikuar letërsisë përfshirë, një gjuhën shqipe dhe angleze, fjalorë të gjuhës italiane dhe angleze të cilat mund të përdoren gjatë leximit në ambienteet e bibliotekës. Një kënd i është dedikuar tërësisht krijuesve roskovecarë, për t'i inkurajuar dhe për të vënë në pah vlerat e zonës sonë. Risia dhe ajo që Drejtoria e Kulturës, Arsimi dhe Sportit synon është :“ Promovimi i letrarëve të rinj dhe krijimi i një mini-vitrine për krijuesit e zonës sonë”

Gjatë periudhës prill-qershori, pranë ambienteve te bibliotekës jan organizuar një sërë aktivitetesh si:

Në 3-mujorin e fundit të vitit 2016 u zhvillua një promovim i profilit të shkrimitarit Mihal Krimçe dhe krijimtarisë së tij. Promovimi i një prej letrarave më të reja të qytetit tonë, Stelina Myftarago me botimin e saj të parë “Korcarja e vogël”. Në Pallatin e Kulturës po i jepet një rëndësi e veçantë talenteve të reja, nga të cilët mund të përmenden, : Nikita Kola (fituese e brezit të zi në artet marcial, karate); Bleona Sinaj (një prej zërave më të rinj dhe premtues të qytetit tonë); Ana Kuqo (e apasionuar pas artit dhe letëresisë, një aktore e ardhshme); Puna e palodhur e gazetarëve të rinj të shkollës 9 vjecare “ Sabri Refiti” Ngjegar, u kurorëzua me publikimin e gazetës së pare “ Mimoza”. Ishte një kënaqësi e pamasë të shihje se si këta të rinj i përkushtohen me kaq shumë dashuri pasioneve të tyre. Një prej aktivitetave me te fundit ishte “ Klubi i lexuesve” në bashkëpunim me OSBE dhe koordinatore Ronada Hoxha. Evidentimi, përzgjedhja dhe trajnimi i tërinjve të apasionuar pas letërsisë ishte një prej temave kyç të këtij aktiviteti. Për t'u regjistruar si anëtar biblioteke nevojitet: një çertifikatë personale, një fotografi me përmasa 40mm x 40mm dhe një mënyrë kontaktimi . Punonjëse e bibliotekës është znj. Mimoza Hazizi.

Ejani në shtëpinë tonë të përbashkët! Jeni të mirëpritur!